



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

P. nr.156/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i përgjithshëm penal, gjyqtarja **Iirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarit U.L. nga fsh.B. K Gj., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP.nr.58/18 të datës 23.02.2018, gjatë shqyrtimit gjyqësor më datë **11.10.2018**, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë - Prokurorit Bajram Kryeziu , përf. të autorizuar të dëmtuarës L. M. si dhe të akuzuarit U. L. , mori dhe të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **U. L.** nga fsh. B.q lagjja B. e M. K Gj.ë ,i biri i L. dhe i nënës M. e gjinisë R. , data e lindjes..., ka të kryer shkollën e mesme ,i pa punë –veteran i luftës ,i gjendjes së mesme ekonomike , shqiptar ,shtetas i R. Kosovës , i pa martuar , me nr.ID

Bazuar në nenin 363 par. 1 pika 1.1 të KPPK-së:

REFUZOHET AKUZA

Sepse :

- **me parë e gjere me dt.06.03.2017**, në shtëpinë e tij në fsh. B. K Gj., ka përdorë energjinë elektrike duke përfituar këtë shërbim në mënyrë të kundërligjshme dhe pa autorizim , ashtu që i pandehuri U. është lidhur me një kablo 3x2.5 për tu furnizuar me rrym elektrike jashtë njehsorit elektrik me nr. 6... dhe me shifrën ... ,ku energjia e shpenzuar nuk është regjistruar në njehsor elektrik, sepse ishte lidhur përmbi qetisë së shtëpisë konkretisht fshehtas në tavan ,me çka të dëmtuarës K... i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 168.67 euro siç është përshkruar kallëzimin penal të dëmtuarës nga shuma e përgjithshme e dëmit 333.83 euro .

-me çka do të kishte kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës

Shpenzimet e procedurës penale, bien në barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës.

A r s y e t i m

Numri i lëndës: 2018:005950
Datë: 11.10.2018
Numri i dokumentit: 00143649

Prokuroria Themelore DP në Gjakovë,
me aktakuzën PP.nr.58/18 të datës 23.02.2018, ka akuzuar të akuzuarin U.L. nga fsh. B.iq K
Gj., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës .

I akuzuari U. L.j , gjatë shqyrtimit fillestar me dt.11.10.2018, duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se nuk e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet sipas aktakuzës.me qene se ne atë shtëpi unë nuk jetoj që 8 vite ,me qene se pas ndarjes se bashkësisë familjare unë jetoj ne një shtëpi tjetër po ne të njëjtin fshatë ku e kam edhe njehsorin i cili është i regjistruar ne emër te birit tim M. L., andaj edhe propozoi qe ne cilësi te dëshmitarit te ftohte vëllai im M. L.i cili jeton ne shtëpi ne te cilën është konstatua keqpërdorimi i njehsorit dhe se i njëjti e ka bere pagesën ne tërësi te demit te shkaktuar te dëmtuarës, kështu qe ne këtë fazë te shqyrtimit gjyqësor heqi dore nga e drejta e paraqitjes se kundërshtimit te provave dhe hudhjes se aktakuzës .

Perf. i autorizuar i te dëmtuarës L.M. ne këtë fazë te shqyrtimi gjyqësor deklaroi se duke dëgjuar deklaratën e dëshmitarit M. L. qe merr ne përgjegjësi te gjitha veprimet qe kanë ndodhur ne 8 vitet e fundit lidhur me njehsorin qe ai shfrytëzon po ashtu edhe nga dëftesa pagesat e K...-s shihet qe pagesa e rikthimit te humbjeve është bere ne tërësi ku me këtë rast kompania ka realizuar demin e shkaktuar nga kjo vepër penale ,ne këtë kuptim tërhiqem nga ndjekja penale respektivisht kallëzimi penale ndaj këtu te akuzuarit U.L. dhe do te shqyrtojë mundësin për ngritjen e kallëzimit te ri penale ndaj këtu dëshmitarit M. L., gjithashtu i prezantojë gjykatën një kopje te pagesës se rikthimit te humbjeve te dt. 08.10.2018.

Prokurori i shteti Bajram Kryeziu pas dëgjimit te dëshmitarit M.L. ne këtë fazë te procedurës deklaroi se tërhiqem nga aktakuza e cila është objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor pasi qe me asnjë provë nuk u vërtetua se këtu i akuzuari U.L. ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet ne aktakuzë. Dëshmitari ne dëshminë e tij para gjykatës deklaroi se ne kete shtëpi jeton qe 8 vite dhe vazhdimisht ka bere pagesën e rrymës elektrike ,mirëpo njehsori ka qene ne emër te U.L. e qe për shkak te obligimeve qe ka pas te pa paguara nuk ka mundur te bart ne emër te tij, ndërsa kallëzimi penal është ushtruar nga dokumentacioni dhe shkresat e lendes si prova te besueshme pa procedurë te provave ne prokurori ,duke marr per bazë se dëshmitari ka paguar te gjithë obligimet qe i ka pasur ndaj kompanisë dhe tani ka rregulluar dokumentacioni qe njehsori te kthehet ne emër te tij u vërtetu si një gjendje tjetër faktike se ndaj te pandehurit U.L. gabimisht është ngutur aktakuza ,andaj heqi dore nga ndjekja penale ,mirëpo me qe ekziston vepra penale kompania K. udhëzohet te ngritë kallëzim te ri penalë .

Pasi që Prokurori është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit , Gjykata në bazë të nenit 363 par. 1 pika 1.1 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 454 par. 1 të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P nr.156/18 të dt. 11.10.2018.

Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci

Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej

Numri i lëndës: 2018:005950

Datë: 11.10.2018

Numri i dokumentit: 00143649

15 ditësh, nga dita

e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës se Apelit ne kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.

Prishtinë. Ankesa në